Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Në bazë të nenit 12, paragrafi 1, 2 pika d) neni 40 të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën 29.10.2026 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë

VENDIM

Neni 1

MIRATOHET Raporti i Auditorit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare vjetore për vitin 2025 dhe Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm.

Neni 2

Për Implementimin e këtij Vendimi Obligohet Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë përkatëse.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Dragashit për vitin 2025 dhe Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve 2025.

Neni 4

Vendimi, hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 24/2024'' dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH
01 Nr. 0601-2554-2126
Dt. 29.10.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Resul Fetahu

Kuvendi Komunal Dragash

Skupstina Opstina Dragash

Municipal Assembly Dragash

Për: Vlora Spanca Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z. Bexhet Xheladini, Kryetar i Komunës së Dragashit

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

2025

Të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Nr	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
1.	Çështja B1 - Klasifikimi i pa saktë i shpenzimeve	Ligji Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, neni 15 parasheh që në rastin e komunës, ndarjet buxhetore nga "Rezerva" me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbarimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ. Këto mjete duhet të merren brenda kufijve buxhetor të përcaktuar me qarkore, përjashtimisht mjetet nga kategoria e pagave dhe mëditjeve.	Kryetari duhet të sigurojë ndarjen e fondeve rezervë për mbulimin ebdetyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore/përmbarimore, në përputhjebme kërkesat ligjore dhe kufijtë buxhetorë të përcaktuar, si dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme që pagesa dhe regjistrimi i transaksioneve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate.	Të veprohet sipas rregullores dhe procedurave të thesarit për klasifikimi e kodeve ekonomike	ZKA,ZKF dhe gjithë zyrtaret financiar	01.08.2026 20.12.2026	Komuna do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar klasifikimin e saktë të shpenzimeve në përputhje me legjislacionin dhe klasifikimin ekonomik në fuqi. Do të forcohen kontrollet e brendshme, do të rritet mbikëqyrja gjatë procesit të

		Ndërsa, Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF - Shpenzimi i parasë publike, neni 18, përcakton që, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, plani kontabël i Thesarit përcakton kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që organizatat buxhetore duhet të aplikojnë. Në tri (3) raste të pagesave të ekzekutuara, me vlerë totale prej 183,000€, Komuna i ka regjistruar shpenzimet në kategori të gabuar ekonomike: - Nga kategoria mallra dhe shërbime janë paguar 105,000€ nga Thesari për vendime përmbarimore për punonjësit e arsimit (paga jubilare dhe shujta) shpenzimet që për nga natyra e i takojnë pagave dhe mëditjeve, dhe - Nga kategoria mallra dhe shërbime dy (2) pagesa në vlerë					regjistrimit të transaksioneve dhe do të ofrohet udhëzim për stafin përgjegjës, me qëllim parandalimin e përsëritjes së rasteve të ngjashme.

		78,000€ janë paguar OJQ-ve për projekt "Shëndet dhe mirëqenje sociale, edukim dhe ambient të pastër për të gjithë" dhe projekti tjetër "Bëhu partneri im për mirëqenie dhe luftën kundër diskriminimit" në bazë të marrëveshjeve për bashkëpunim dhe bashkëfinancim që për nga natyra këto pagesa i takojnë kategorisë ekonomike subvencione dhe transfere. Këto gabime kanë ndodhur për shkak të mungesës së planifikimit të saktë buxhetor për këto lloje detyrimesh në kategorinë përkatëse.					
2.	Çështja B2 - Mangësi në evidentimin e pasurisë	Sipas nenit 6 paragrafi 3 i rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore përcakton që pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria". Po ashtu sipas	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e saj janë të regjistruara në regjistra përkatës, si dhe për pasuritë nën 1,000€ duhet të sigurojë që janë aplikuar normat e zhvlerësimit, në mënyrë që prezantimi i tyre në	Të kryhet inventarizimi dhe verifikimi i plotë i pasurisë komunale. Të harmonizohen regjistrat e pasurisë me	Kryetari i komunës, si dhe të gjitha drejtoritë perkatëse dhe Zyrtari i Pasurisë.	10.08.2026 deri ne fund të vitin 2026	Komuna do të ndërmarrë masat e nevojshme për të përmirësuar evidentimin dhe menaxhimin e pasurisë. Do të kryhet harmonizimi i regjistrit të

		nenit 22 paragrafi 1,2,3 të rreg. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, zhvlerësimi i pasurive bëhet sipas metodës drejtëvizore. Pasuritë duhet të vlerësohen duke marrë parasysh zhvlerësimin që është grumbulluar nga momenti i blerjes së pasurisë. Zhvlerësimi llogaritet në baza mujore, pasuria nuk zhvlerësohet për muajin e blerjes dhe të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit. Komuna kishte formuar komisione për inventarizimin e pasurive jo financiare dhe komisionet i kishin hartuar raporte individual të pasurive nën 1,000€, në vlerë financiare prej: 126,628€, për cdo njësi organizative të komunës dhe një raport të përmbledhur për pasuritë mbi 1,000€, në vlerë	PFV të jetë i plotë dhe i saktë..	gjendjen faktike dhe dokumentacionin mbështetës. Të regjistrohen me kohë të gjitha pasuritë e reja dhe të përditësohen ndryshimet në regjistrin e pasurisë. Të forcohen kontrollet e brendshme për evidentimin, lëvizjen dhe çregjistrimin e pasurisë. Të monitorohet zbatimi i procedurave për menaxhimin e pasurisë për të siguruar evidencë të plotë, të saktë			pasurisë me gjendjen faktike, do të përditësohen regjistrat përkatës dhe do të forcohen kontrollet e brendshme për të siguruar që të gjitha pasuritë të regjistrohen dhe të menaxhohen në përputhje me legjislacionin dhe procedurat në fuqi.

		financiare prej: 8,165,044€, mirëpo nuk kishin përgatitur një raport të përgjithshëm të inventarizimit. Po ashtu komuna nuk ka arritur t'i regjistrojë të gjitha pasuritë nën 1,000€ në e-pasuri kjo ka ndodhë për arsye se komuna ka bërë disa shkresa në drejtim të MAPL-së dhe ka pasur disa takime për ta rregulluar sistemin, por nuk ka pasur efekt. Në testimin e pasurive mbi 1,000€ nuk kemi vërejtur pasuri të cilat nuk janë regjistruar në SIMFK, ndërsa pasuritë nën 1,000€ janë prezantuar në PFV në vlerë totale prandaj, nuk ishte e mundur të identifikohej se cilat pasuri ishin regjistruar dhe a është përllogaritur zhvlerësimi i tërë pasurisë. Pasuritë nën 1,000€, të prezentuara në PFV për vitin 2025 ishin 1,257,716€, me një zvogëlim krahasuar me		dhe të përditësuar.			

		vitin e kaluar për 336,761€.					
3.	Çështja B3 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme	Sipas nenit 26 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr.06/L-005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjete (10) Eurove dhe neni 27 Nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjoben nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në perputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditë pune pas ditës se fundit për pages, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo me vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar	Kryetari duhet të sigurojë që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika, rregullore dhe mekanizma tjerë me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e të arkëtueshmeve. Po ashtu, duhet shqyrtuar të gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj debitorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet	Të bëhet identifikimi dhe azhurnimi i plotë i të gjitha llogarive të arkëtueshme. Të hartohet një plan për arkëtimin e borxheve ekzistuese me afate të qarta dhe prioritizim të rasteve. Të dërgohen njoftime zyrtare për debitorët dhe të ndiqen procedurat për rikuperimin e borxheve. Të ndërmerren masa administrative	Kryetari i Komunës, Drejtori për Ekonomi Financa dhe Zhvillim.	01.08.2026 e deri ne vitin 2027	Komuna do të ndërmarrë masa për përmirësimin e menaxhimit të llogarive të arkëtueshme. Do të përditësohen regjistrat e debitorëve, do të intensifikohet procesi i arkëtimit përmes njoftimeve dhe masave administrative dhe ligjore, si dhe do të forcohet monitorimi dhe raportimi periodik me qëllim rritjen e efikasitetit në mbledhjen e të hyrave.

		konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Komuna e Dragashit në PFV e vitit 2025 ka shpalosur llogari të arkëtueshme (LLA) në vlerë prej 2,585,529€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë 2,295,836€, tatimi në tokë 192,996€ dhe shfrytezimi i prones komunale 96,697€, vetëm tatimi në pronë është rritur për 894,287€ në krahasim me vitin 2024. Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme është mospërmbushja e detyrimeve ligjore nga ana e komunës për ndjekjen dhe mbledhjen e borxheve tatimore.		dhe ligjore ndaj debitorëve që nuk përmbushin obligimet. Të vendoset monitorim i rregullt i llogarive të arkëtueshme dhe raportim periodik te menaxhmenti. Të forcohen kontrollet e brendshme për regjistrimin, ndjekjen dhe arkëtimin e të hyrave.			
4.	Çështja B4 - Mos kompletimi i	Rregulloren QRK - NR 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen	Të ndërmerren procedurat për plotësimin e	Kryetari i komunes dhe	01/08/2026	Komuna ka filluar procedurat e rekrutimit për

	Njësisë së Auditimit të Brendshëm	të audititmit të brendshëm në subjektin e sektorit public, neni 5.1.1 përcakton se çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë se paku tre auditor. Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Dragashit, përbëhet vetëm nga Udhëheqësi i Njësisë se auditimit dhe nuk ka anëtar tjerë si auditor të brendshëm. Komuna nuk ka ndërmarre veprime të duhura për ta trajtuar çështjen e përberjës dhe funksionit të Njësisë se Auditimit të brendshëm për ta kompletuar me staf të duhur.	planifikimet buxhetore me kohë dhe që NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshem sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohsisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.	pozitave të lira në Njësinë e Auditimit të Brendshëm në përputhje me strukturën organizative. Të shpallen konkurse publike për rekrutimin e auditorëve të brendshëm të kualifikuar. Të sigurohet që përzgjedhja e stafit të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet profesionale të auditimit.	Udheqja e njesis së auditimit të brendshem	Deri në fund të vitit 2026	plotësimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm. Procesi do të vazhdojë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe strukturën organizative të miratuar, me qëllim sigurimin e funksionimit të plotë dhe efektiv të njësisë dhe forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Kryesuesi i Kuvendit

Resul Fetahu